



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Kryetarja

Nr. 1210 Prot.

Tiranë, më 02.04 2024

URDHËR
Nr.17, datë 2.4.2024

PËR MBLEDHJEN E KUVENDIT NË SEANCË PLENARE NË DATËN 4.4.2024, ORA 10.00

Në mbështetje të nenit 7, pika 6, nenit 27/1 të Rregullores së Kuvendit, bazuar në kalendarin e punimeve për periudhën 18 mars – 5 prill 2024,

URDHËROJ:

I. Mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare në datën 4.4.2024, ora 10:00.

II. Rendi i ditës i seancës plenare është si më poshtë:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 21.3.2024.
2. Njoftime.
3. Interpelancë me ministren e Turizmit dhe Mjedisit, zonjën Mirela Kumbaro, kërkuar nga deputetja Ina Zhupa.
4. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat””.
5. Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat””, të ndryshuar.
6. Projektligj “Për burimet ujore” (për votim).
7. Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar (për votim).
8. Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (për votim).
9. Projektligj “Për një ndryshim në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar” (për votim).
10. Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional” (për votim).
11. Projektvendim “Për zgjedhjen Komisioner në Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor në institucionin e Avokatit të Popullit”.
12. Projektvendim “Për zgjedhjen Komisioner në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre në institucionin e Avokatit të Popullit”.
13. Projektvendim “Për zgjedhjen Komisioner në Seksionin e Përgjithshëm pranë Avokatit të Popullit”.
14. Projektvendim “Për propozimin e një anëtarit të Komisionit të Prokurimit Publik”.
15. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.

III. Ngarkohen shërbimet e Kuvendit për publikimin e rendit të ditës të seancës plenare, njoftimin e anëtarëve të Kuvendit me anë të mjeteve të komunikimit elektronik, si dhe përgatitjen e dokumentacionit parlamentar që do të shqyrtohet.

IV. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE

Lindita NIKOLLA





SEANCË PLENARE PUBLIKE

E enjte, 4 prill 2024, ora 10.00

RENDI I DITËS

Në mbështetje të urdhrin nr. 17, datë 2.4.2024 të Kryetares së Kuvendit, znj. Lindita Nikolla, rendi i ditës është si më poshtë vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 21.3.2024.
(Neni 44, pika 2 e Rregullores së Kuvendit)
2. Njoftime
(Neni 44, pika 3 e Rregullores së Kuvendit)
3. **Interpelancë me ministren e Turizmit dhe Mjedisit zonjën Mirela Kumbaro, kërkuar nga deputetja Ina Zhupa.**
(Neni 80 i Kushtetutës, neni 96 e Rregullores së Kuvendit).
4. **Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat””.**
(Në mbështetje të neneve 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)
Pyetje
Shprehet nismëtari.
Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.
Dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.
Dhënie mendimi Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.
Diskutime
(Shprehen grupet parlamentare.)
Koha e votimit
5. **Projektligj “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar.**
(Në mbështetje të nenit 81, pika 1 dhe 2 të Kushtetutës, dhe neneve 55, 68 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

6. **Projektligj “Për burimet ujore”.**

(Në mbështetje të neneve 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Koha e votimit

7. **Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 93/2015 “Për Turizmin”, të ndryshuar”.**

(Në mbështetje të neneve 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Koha e votimit

8. **Projektligj “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 55/2015 “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.**

(Në mbështetje të nenit 81, pika 1 dhe 2, të Kushtetutës, dhe neneve 55, 68 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Koha e votimit

9. **Projektligj “Për një ndryshim në ligjin nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.**

(Në mbështetje të nenit 81, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55, 68 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Koha e votimit

10. **Projektligj “Për disa ndryshime në ligjin nr. 15/2017, datë 16.2.2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”**

(Në mbështetje të nenit 81, pika 1, të Kushtetutës, dhe neneve 55, 68 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Koha e votimit

11. **Projektvendim “Për zgjedhjen Komisioner në Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor në institucionin e Avokatit të Popullit”.**

(Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit shumicë e thjeshtë votash për miratim.)

12. **Projektvendim “Për zgjedhjen Komisioner në Seksionin për Organet e Administratës Qendrore, të Pushtetit Vendor dhe të të Tretëve që Veprojnë për Llogari të Tyre në institucionin e Avokatit të Popullit”.**
(Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit shumicë e thjeshtë votash për miratim.)

13. **Projektvendim “Për zgjedhjen Komisioner në Seksionin e Përgjithshëm pranë Avokatit të Popullit”**
(Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit shumicë e thjeshtë votash për miratim.)

14. **Projektvendim “Për propozimin e një anëtari të Komisionit të Prokurimit Publik”.**
(Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit shumicë e thjeshtë votash për miratim.)

15. **Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës.**
(Në mbështetje të nenit 45 të Rregullores së Kuvendit: Çdo deputet mund të flasë jo më shumë se 5 minuta dhe nëse diskuton në emër të grupit parlamentar, jo më shumë se 8 minuta. Koha e diskutimeve për çështje jashtë rendit të ditës nuk mund të jetë më shumë se 60 minuta.)